



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 11 shtator 2018.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, dhe Nuri Belba.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Bardh Spahia, Vangjel Tavo, Floida Kërpaçi, Grida Shqina., Halim Kosova, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

Të ftuar:

Dajna Sorensen –Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Genta Prodani - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Hapim mbledhjen e Komisionit për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë!

Në pikën e parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 11.09.2018. A janë të gjithë dakord? Dakord.

Në pikën e dytë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Marrin pjesë në komision zëvendësministria e, zonja Dajna Sorensen dhe specialistja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Genta Prodani.

Fjala për ju.

Dajna Sorensen – Përshëndetje të gjithëve!

Marrëveshja e zbatimit është në kuadër të projektit “Këshillim për migracionin”, e cila në vetvete është pjesë e projektit global “Migracion për zhvillim”, i autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Projekti në vetvete synon të luftojë migracionin e parregullt nëpërmjet një sërë masash, që kanë të bëjnë me informimin e personave, të cilët janë target potencial për migracion jo të rregullt, për mundësitë që ofrohen në punësim në tregun shqiptar, informim për arsimin profesional dhe tregun e punës në vend, si dhe informacion për rrugët e ligjshme të migracionit të punës, konkretisht në Gjermani.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë nëpërmjet GIZ-it ofron një vlerë financiare 1,5 milionë euro, i cili është kontribut gjerman.

Për sa u përket outputeve apo produkteve kryesore që parashikohen në kuadër të këtij projekti, ato kanë të bëjnë në radhë të parë me një sërë paketash informative dhe botimin e informacionit për migrimin e rregullt në Gjermani dhe këshillim për perspektivat e tregut të punës dhe me ngritjen e kapaciteteve të sporteleve të migracionit në Shqipëri. Kjo në vetvete ka të bëjë ekskluzivisht me persona, të cilët janë emigrantë të kthyer rishtazi në Shqipëri. Sportelet e migracionit janë të vendosura pranë zyrave të punës për të asistuar të gjithë ata emigrantë të kthyer rishtazi për mundësi të ndryshme për t’u integruar në tregun e punës dhe për të marrë informacion, në qoftë se ata kanë nevojë, për kurse profesionale shtesë për t’i bërë ata të aftë për t’u integruar në tregun e punës.

Parashikohet krijimi i një faqeje interneti me të gjithë informacionin e nevojshëm pikërisht për ta targetuar këtë grup; hartimi i një strategjie për marrëdhëniet me publikun në

sportelet e migracionit pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit; hartimi i një dokumenti strategjik për Ministrinë e Financave për sa i përket politikëbërjes për migracionin e punësimit të orientuar drejt zhvillimit; hartimi i një manuali pune për specialistët që punojnë pranë sporteleve të migracionit dhe dhënia e një kontributi financiar për organizime të ndryshme, për konferenca e të tjera në lidhje me temat e migracionit dhe çështje të ndryshme të punësimit.

Parashikohet që projekti të ketë impakt të drejtpërdrejtë për rreth 2000 persona, të cilët do të marrin informacion nëpërmjet sporteleve të migracionit. Projektmarrëveshja në vetvete do të jetë në fuqi deri më 30 nëntor të vitit 2020.

Për sa i përket elementit financiar dhe kostos financiare në buxhetin e shtetit, bëhet fjalë për shpenzime lokale në vlerën 90 mijë euro për periudhën 2018-2020.

Ilir Pendavinji – Sa sportele do të jenë dhe ku do të hapen?

Dajna Sorensen – Sportelet janë të hapura tashmë në zyrat e punës.

Edlira Bode – Në të gjitha bashkitë?

Dajna Sorensen – Jo, në të gjitha bashkitë, por në 36 zona, ku ka edhe zyra pune. Sportel migracioni ndoshta është fjalë e madhe, por zakonisht është një person, i cili është specializuar për t'i shërbyer pikërisht këtij target grupi.

Elisa Spiropali – A do të ketë logjistikë të dallueshme?

Dajna Sorensen – Po, do të jetë një person që është kastile për sportelet e migracionit...

Elisa Spiropali – Në këto kushte, njerëzve përgjithësisht u mungon informacioni; nuk dinë ku të shkojnë, ku të orientohen, kush i pret. Pra, duhet të ketë një informim të mirë të publikut.

Dajna Sorensen – Ky projekt do të rrisë infrastrukturën informative, qoftë edhe në pikat kufitare. Edhe sot në disa nga pikat kufitare kryesore, ku kthehen emigrantët tanë, faktikisht, ka disa banera dhe fletëpalosje specifike për t'i orientuar drejt sporteleve të migracionit. Megjithatë, duhet thënë se vetëm një fraksion i vogël i personave, të cilët kthehen aksesojnë shërbimin.

Në Komisionin e Ligjeve përgatitëm një informacion të detajuar se sa ka qenë numri aktual i personave të hyrë në Republikën e Shqipërisë për vitin 2018. Nga ky informacion doli që të regjistruar pranë zyrave të punës janë 530, aktualisht, që i kanë aksesuar këto shërbime. Po bashkëpunojmë me Ministrinë Brendshme

Elisa Spiropali – Sa është totali i përkthyer, a e keni këtë informacion?

Dajna Sorensen – Këtë informacion mund ta gjejmë, sepse nuk mund ta nxirrim dot për sot.

Elisa Spiropali – Po sa për qind u drejtohen?

Dajna Sorensen – Ne informacion në këtë moment kemi vetëm për personat që aktualisht aksesojnë këto lloj shërbimesh pranë sporteleve...

Arben Kamami – Do jetë një person i tretë brenda stafit aktual të zyrave të punës, apo do të vijë një person tjetër?

Dajna Sorensen – Jo është stafi aktual.

Arben Kamami – A janë të trajnuar për këtë problem, apo do të fillojë trajnimi tani?

Dajna Sorensen – Jo sportelet e migracionit kanë funksionuar prej vitesh dhe janë ndërtuar në kuadër të bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit.

Arben Kamami - A janë që nga koha e IOM-it?

Dajna Sorensen – Kanë filluar që në vitin 2010.

Arben Kamami – Unë me sa di në Elbasan nuk funksionon, por do të pyes drejtoreshën.

Faleminderit!

Edlira Bode – Targetgrupi, pra qëllimi i këtyre sporteleve, janë ata që kthehen? Në fakt, ne duhet të punojmë më shumë me ata që janë në Shqipëri për t'i informuar që këtu ka mundësi dhe të mos largohen.

Dajna Sorensen – Të dyja janë targetgrupe dhe u shërbejnë atyre që janë kthyer rishtas. Kuptohet që ky projekt është iniciuar nga qeveria gjermane në momentin që pati një fluks relativisht të lartë të emigrantëve që shkuan në këto vende dhe ka qenë një përgjigje ndaj atij fluksi emigrantësh jo të rregullt. Me këtë synim projekti në vetvete nuk informon vetëm kategorinë e të kthyerve, por edhe ata që janë aktualë. Prandaj projekti në vetvete i ka të gjitha paketat informative, të cilat do të jenë të aksesueshme për të gjithë qytetarët, jo vetëm për emigrantët e kthyer.

Ilir Pendavinji - Si i identifikohen këto potenciale, që janë potencialisht për të ikur?

Dajna Sorensen – Normalisht janë klientët e zyrave të punës ata të cilët janë punëkërkues të papunë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ilir Pendavinji - Unë kam parë para 2-3 ditësh një emision, ku merrnin në intervistë disa të rinj dhe i pyesnin pse donin të bëheshin infermierë dhe përgjigjja e tyre ishte: “Sepse duam të ikim në Gjermani”. Media e bën këtë rrokulli dhe duket sikur u jep impulse këtyre njerëzve për të ikur.

(Diskutime pa mikrofon.)

Roland Xhelilaj – Unë kam vetëm një merak: ju thatë se është një shifër prej 2 mijë vetash, që duan të marrin informacion të parashikuar te këto zyra. A përfshijnë këto ndonjë

fushë të caktuar apo edhe një punëtor i zakonshëm, një punëtor krahu, njerëz që kanë nevojë për bukë e gojës mund të paraqiten te këto zyra? Pra, a ka nivele të caktuara arsimimi, profesioneve e të tjera me radhë?

Dajna Sorensen – Nuk është se na ka ardhur ndonjë mesazh për të evidentuar grupe të ndryshme. Unë besoj se kjo do të dalë gjatë fillimit të procesit të projektit për të identifikuar dhe për të verifikuar atë mesazh sipas grupeve të ndryshme.

Roland Xhelilaj – Problemi është se me këtë gjë duhet të punohet në vazhdimësi për t'iu drejtuar këtyre zyrave dhe për të pasur kuptim të saktë për migrimin për kërkesat që ka për të qenë një emigrant i rregullt.

Dajna Sorensen – Me lejon të them diçka, duke pasur parasysh karakterin e kërkuesve të papunë të regjistruar pranë zyrave të punës, mund të them se 96% e këtyre kërkuesve kanë nivel arsimor të mesëm ose më pak. Pra, 82% e tyre kanë arsim 9-vjeçar ose më pak, kështu që në vetvete deri diku kjo është e përcaktuar.

Edlira Bode – Në lidhje me emigrantët e paligjshëm, a janë parë në këtë aspekt çfarë arsime kanë përgjithësisht?

Dajna Sorensen – Nuk kemi informacion për këtë gjë.

Edlira Bode – Ne duhet të kuptojmë një gjë: a janë këta persona, të cilët nuk gjejnë dot punë në Shqipëri dhe ikin apo janë ata, të cilët e kanë një mundësi punësimi, por përsëri vendosin të largohen?

Dajna Sorensen – Në një pyetësor që është bërë, një nga pyetjet ishte: a po ikni për arsye, sepse ju mungon vendi i punës? Përgjigjja: vetëm 5% prej tyre ishte, sepse nuk kishin një vend pune, por ama 94% thoshin: “Po ikim për punë më të mirë”. Pra, nuk është çështje për mungesë të numrit të vendeve të punës, sesa është cilësia e vendeve të punës për këtë kategori.

Elisa Spiropali – A ka ndonjë diskutim tjetër? Nuk ka. Hedhim në votim projektligjin.

Kush është dakord me projektligjin në parim? 10 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 10 vota.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. “Ratifikimi i marrëveshjes dhe zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar, GIZ, për projektin e këshillimit të migracionit në Shqipëri” sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 10 vota.

Neni 2. “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është pro?
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 10 vota.

E votojmë në tërësi. Pro? 10 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Projektligji miratohet edhe në tërësi me 10 vota.

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA